

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

MODELIM

Niveli II

(Në drejtimin mësimor Tekstil-konfeksione)

Kodi: D3-II-18

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2018

Përmbajtja:

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Modelim”, niveli II, të drejtimit mësimor “Tekstil-Konfeksione”.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Modelim”, niveli II.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Modelim”, niveli II
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Modelim”, niveli II
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Modelim”, niveli II
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në në profilin “Modelim”, niveli II.

III. Plani mësimor për profilin “Modelim”, niveli II.

IV. Udhëzime për planin mësimor

V. Udhëzime për procesin mësimor.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Modelim”, niveli II,

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Modelim”, niveli II, të drejtimit “Tekstil-Konfeksione”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Modelim”, niveli II, të drejtimit “Tekstil-Konfeksione”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me sektorin e modelimit të veshjeve”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Modelim”, niveli II

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Modelim”, niveli II

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Modelim” niveli II, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Tekstil-Konfeksione”, niveli I;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit në profilin “Modelim”, niveli II

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Modelim”, niveli II, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Modelim”, niv. II

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Modelim”, niveli II, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin I, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të organizojë vendin e punës.
- Të interpretojë skicën (vizatimin) nga stilisti.
- Të zbërthejë në detaje skicën.
- Të përzgjedhë pëlhurën në varësi të modelit në skicë.
- Të përzgjedhë materialet ndihmëse dhe aksesoret e qepjes në varësi me skicën.
- Të përgatisë kallëpet e prerjes bazuar në skicë.
- Të presë materialin
- Të ndjekë tërësinë e procesit të prodhimit
- Të shpërndajë punën tek stafit.
- Të përzgjedhë metodën e montimit të qepjes.
- Të realizojë ekonomizimin e lëndës së parë, nëpërmjet një llogaritjeje të thjeshtë.
- Të përshkruajë vetitë fiziko mekanike të tekstilit.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik
- Të zbatojë rregullat e ruajtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.
- Të mirëmbajë mjetet dhe pajisjet e punës

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Modelim”, niveli II.



Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Modelim”, niveli II, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës si modelist në reparte industriale dhe artizanale.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin III (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin përkatës, për të fituar diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Modelim”, niveli II

Plani mësimor për profilin mësimor “Modelim”, niveli II			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/ Vjetore
			Klasa 12
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	8/9 (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		TIK	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	7 (238)
1	L-17-157-10	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-10-400-16	Merceologji tekstili	2
3	L-01-401-16	Vizatim modelesh	1
4	L-10-402-16	Moda dhe estetika	2
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	12 (408)
1	M-10-1242-16	Analiza e vetive fiziko-mekanike të fillit dhe tekstileve	51
2	M-10-1243-16	Zbëthim modelesh fundi	51
3	M-10-1244-16	Zbëthim modelesh bluze	51
4	M-10-1245-16	Zbëthim modelesh pantalloni	51
5	M-10-1246-16	Zbëthim modelesh xhakete	85
6	M-10-1247-16	Zbëthim modelesh pallto	68
7	M-10-1248-16	Aksesorët për veshje dhe arredim	51
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	3 (102)
1	M-01-1249-16	Vizatim i lirë	51
2	M-01-1250-16	Pikturë	51
3	M-33-1251-16	Plastikë	51



		Gjithsej A+B+C+D	30/31 (1020/ 1054)
--	--	-------------------------	---------------------------------

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime)

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Modelim”, niveli II, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Modelim”, niveli II.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimin (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk*



ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Modelim”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Modelim”, niveli II, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e rrobaqepsisë, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit II.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Modelim”, niveli II

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Modelim”, niveli II, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësisimit profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;
 - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit II.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-10). Kl. 12 – 68 orë

- **Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë sipërmarrjen me të gjithë elementët kryesorë të saj
- Të shpjegojnë lidhjen midis sipërmarrjes dhe veprimtarisë njerëzore
- Të analizojnë ndikimin e sipërmarrjes në biznes
- Të shpjegojnë funksionet themelore të menaxhimit në biznes
- Të shpjegojnë se si funksionon tregu
- Të shpjegojnë veprimtaritë kryesore të bankave të niveleve të dyta
- Të shpjegojnë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut
- Të listojnë katër "P"-të e marketingut
- Të përshkruajnë konceptet bazë të legjislacionit dhe etikës së biznesit.
- Të shpjegojnë rëndësinë e legjislacionit të punës dhe elementet përbërës të tij.
- Të kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës
- Të shpjegojnë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12 - 68 orë**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme mbi sipërmarrjen	3 orë
Tema 2	Kërkimi sipërmarrës dhe aktiviteti njerëzor	4 orë
Tema 3	Sipërmarrja dhe biznesi	8 orë
Tema 4	Menaxhimi dhe organizimi i punës në biznes	10 orë
Tema 5	Tregu	7 orë
Tema 6	Paraja, bankat dhe krediti	7 orë
Tema 7	Njohuri për marketingun	5 orë
Tema 8	Legjislacioni dhe etika e biznesit	6 orë
Tema 9	Legjislacioni i punës	7 orë
Tema 10	Llogaritje të thjeshta ekonomike	9 orë
Tema 11	Aspekte të TIK-ut në biznes	2 orë

2. Lënda “Merceologji tekstili” (L-10-400-16). Kl. 12 – 68 orë

- **Synimet e lëndës “Merceologji tekstili” kl. 12 - 68 orë.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Merceologji tekstili”, kl 12, nxënësit duhet:

- Të tregojnë me anë të shikimit apo prekjes fijet që përbëjnë pëlhurën.
- Të identifikojnë me anë të djegjes fijet që përbëjnë pëlhurën.
- Të përshkruajnë përpunimin industrial të fibrave tekstile.
- Të interpretojnë sistemet e matjes dhe tregusit e tyre.
- Të listojnë përbërësit e kërpit dhe jutës.

- Të përshkruajnë llojet e fibrave minerale.
- Të përshkruajnë fibrat artificiale dhe vetitë e tyre.
- Të interpretojnë tregusit e fillit.
- Të identifikojnë me anë të mikroskopit dhe analizës kimike fijet që përbëjnë pëlhurën.
- Të dallojnë llojet e pëlhurave.
- Të dallojnë llojet e thurjeve në pëlhurë.
- Të përshkruajnë llojet e ngjyruesve.
- Të përshkruajnë mënyrat e ngjyrimin të pëlhurave.
- Të dallojnë llojet e trikotazheve.
- Të interpretojnë elasticitetin e trikotazheve.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Merceologji tekstili”, kl. 12 - 68 orë**

Tema 1	Fibrat tekstile.Leshi	6 orë
Tema 2	Mëndafshi	5 orë
Tema 3	Pambuku	5 orë
Tema 4	Liri	3 orë
Tema 5	Kërpi,juta dhe fibrat minore	6 orë
Tema 6	Fibrat artificiale dhe sintetike	8 orë
Tema 7	Filli dhe treguesit e tij	7 orë
Tema 8	Pëlhurat	12 orë
Tema 9	Ngjyruesit dhe klasifikimi i tyre	8 orë
Tema 10	Trikotazhet	8 orë

3. Lënda “Vizatim modelesh” (L-01-401-16). Kl. 12 – 34 orë

• **Synimet e lëndës “Vizatim modelesh”, kl. 12 - 34 orë.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Vizatim modelesh”, kl 12, nxënësit duhet:

- Të interpretojnë rëndësinë e ngjyrave në vitamin e modeleve.
- Të përshkruajnë si realizohet një vizatim skematik(me pamje para dhe mbrapa).
- Të përshkruajnë si zërthehen pjesët përbërëse të një modeli veshjeje.
- Të realizojnë modele të ndryshme veshje me anë të vizatimit.
- Të analizojnë ndikimin e materialit në modelet e veshjeve.
- Të interpretojnë përzgjedhjen e ngjyrave dhe dizenjove në një vizatim.
- Të realizojnë dekoracione dhe aksesore në vizatimin e veshjeve.
- Të realizojnë vizatime të modeleve të ndryshme të veshjeve për femra dhe meshkuj.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Vizatim modelesh”, kl. 12 - 34 orë**

Tema 1	Njohuri mbi ngjyrat dhe ndarja e raportit të tyre	2 orë
Tema 2	Vizatimi i fundeve të modeluara për femra	3 orë
Tema 3	Vizatimi i bluzave të modeluara për femra	4orë
Tema 4	Vizatimi i fustaneve të modeluara për femra	5 orë

Edmond

Tema 5	Vizatimi i këmishave të modeluara për meshkuj	4 orë
Tema 6	Vizatimi i pantallonave të modeluara për meshkuj	5 orë
Tema 7	Vizatimi i xhaketave të modeluara për femra e meshkuj	6 orë
Tema 8	Vizatimi i palltove të modeluara për femra e meshkuj	5 orë

4. Lënda “Moda dhe estetika” (L-10-402-16). Kl. 12 – 68 orë

- **Synimet e lëndës “Moda dhe estetika” kl. 12 - 68 orë.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Moda dhe estetika”, kl 12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojë kuptimin, rëndësinë dhe evoluimin historik të modës.
- Të shpjegojë kuptimin për estetikën duke argumentuar me shembuj.
- Të prezantojë përmes një projekti konceptet e estetikës përmes shembujve.
- Të shpjegojë ndikimin e modës dhe estetikës në procesin e modelimit.
- Të shpjegojë periudhat kyçe të historisë së kostumit duke e argumentuar me shembuj konkretë.
- Të prezantojë përmes një projekti periudhat dhe modelet me tipike që shënojnë historinë.
- Të dallojë veçoritë e modës në ditët tona si një domosdoshmëri.
- Të argumentojë me shembuj konceptet bazë të estetikës
- Të argumentojë dhe të prezantojë përmes shembujve konkretë aspektet e të bukurës dhe të shëmtuarës, etj.
- Të shpjegojë kuptimin për stilin dhe prezantojë shembuj të stilistëve më të spikatur.
- Të dallojë individualitetet, risitë dhe tendenca në modë.
- Të koleksionojë dhe prezantojë materialet dhe teknikat respektive të realizimit të modelimit me estetikë.
- Të prezantojë portofolin e punëve dhe projekteve referuar tematikave të lëndës.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Moda dhe estetika”, kl. 12 - 68 orë**

Tema 1	Hyrje ne historinë e modës dhe estetikës.	2 orë
Tema 2	Periudhat më të rëndësishme të historisë së kostumit	6 orë
Tema 3	Koncepti i modës dhe evolimii saj historik.	6 orë
Tema 4	Moda dhe prania në ditët tona si një domosdoshmëri	6 orë
Tema 5	Estetika, konceptet bazë të saj (e bukura, e shëmtuara, e madhërishtë, etj)	5 orë
Tema 6	E bukura në modë si një koncept parësor (klasi dhe finesa)	4 orë
Tema 7	E shëmtuara dhe vulgariteti	4 orë
Tema 8	Koncepti i stilit dhe kuptimi i tij, disa stiliste të rëndësishëm si shembuj.	6 orë
Tema 9	Individualitet, risite dhe tendenca në modë.	8 orë
Tema 10	Materialet dhe teknikat e realizimit me estetikë në modelimin e veshjeve dhe aksesorëve	12 orë
Tema 11	Kostumet kombëtare dhe estetika e realizimit të tyre	5 orë
Tema 12	Portofoli i projekteve për modën, referuar periudhave historike, materialeve dhe estetikës	4 orë



IX. Përshkruesit e moduleve të detyruar të praktikës profesionale

1. Moduli “Analiza e vetive fiziko-mekanike të fillit dhe tekstileve”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione

Profili: Modelim

Niveli: II

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	ANALIZA E VETIVE FIZIKO-MEKANIKE TË FILLIT DHE TEKSTILEVE	M-10-1242-16
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer veprimtari praktike për të analizuar vetitë fiziko-mekanike të fijeve dhe tekstileve të ndryshme	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Tekstil – Konfeksion.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi analizon vetitë e fijeve të ndryshme.</p> <p>Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.- Përzgjedhja e disa lloj fijesh përthurje dhe qepje.- Identifikimi i fijeve sipas procesit që kryejnë.- Përcaktimi i llojit të fibrës (ose fibrave) të fillit.- Matja e numrit metrik të fijeve të ndryshme.- Përcaktimi i sasisë së fijeve të bashkuara.- Përcaktimi i drejtimit të dredhjeve të fillit.- Matja e gjatësisë këputëse të fijeve të ndryshme.- Kontrolli i elasticitetit të fijeve.- Pastrimi i vendit të punës.- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;- të përzgjedhë materialet e duhura të punës;- të identifikojë llojet e fijeve sipas proceseve që kryejnë;- të përcaktojë llojin e fibrës (ose fibrave) me anë të prekjës	

-
- ose djegjes;
 - të kryejë matjet e numrit metrik të fijeve të ndryshme;
 - të përcaktojë sasinë e fijeve të bashkuara në fije të ndryshme (me anë të ç'përdredhjes së fijeve);
 - të përcaktojë drejtimit e dredhjeve të fillit (e majtë ose e djathtë);
 - të masë gjatësisë këputëse të fijeve të ndryshme;
 - të kontrollojë elasticitetit e fijeve me anë të tërheqjes;
 - të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 2 Nxënësi analizon vetitë e pëlhurave të tezgjahut.

Përmbajtja

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e materialeve të punës (lloje të ndryshme pëlhurash.
- Prerja e 1 m gjatësi të pëlhurave të ndryshme.
- Matja e gjërësisë së pëlhurave të ndryshme.
- Përcaktimi i drejtimit të fijeve bazë dhe ind.
- Përcaktimi i anës së mbarë dhe të praptë të pëlhurave të ndryshme.
- Identifikimi i fijeve (lloj i fibrave) përbërëse.
- Përcaktimi i llojit të thurjes.
- Llogaritja e dendësisë së fijeve bazë dhe ind në 10 cm.
- Llogaritja e sasisë totale të fijeve të bazës.
- Analiza e qëndrueshmërisë në këputje.
- Analiza e qëndrueshmërisë së ngjyrave.
- Llogaritja e hyrjes në ujë.
- Përcaktimi i vetive qepëse.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e duhura të punës;
- të përcaktojë gjërësinë e pëlhurave të ndryshme;
- të përcaktojë drejtimin e fijeve bazë dhe ind;
- të përcaktojë anën e mbarë dhe të praptë të pëlhurave të ndryshme me anë të prekjes dhe shikimit;
- të identifikojë fijet (llojet e fibrave me anë të procesit të djegjes ose me mikroskop);

- të përcaktojë llojet e thurjes me anë të shqepjes(ose me lupë);
- të llogarisë dendësisë së fijeve bazë dhe ind në 10 cm;
- të llogarisë sasisë totale të fijeve të bazës;
- të analizojë qëndrueshmërisë në këputje të pëlhurave të ndryshme;
- të analizojë qëndrueshmërisë e ngjyrave me anë të futjes në ujë;
- të llogarisë hyrjen në ujë me anë të matjeve(zhubrosjen);
- të përcaktojë vetitë qepëse të pëlhurave të ndryshme;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 3 Nxënësi analizon vetitë e trikotazheve.

Përmbajtja

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e materialeve të punës.
- Identifikimi i lëndës së parë, që është realizuar trikotazhi.
- Përcaktimi i llojit të thurjes.
- Përcaktimi i drejtimit të elasticitetit të trikotazheve.
- Llogaritja e koeficientit të zgjatjes dhe rikthimit të trikotazheve.
- Matja e koeficientit të elasticitetit.
- Përcaktimi i shthurjes së trikotazheve.
- Identifikimi i defektit të përdredhjes së trikotazheve.
- Përcaktimi i trashësisë së trikotazheve.
- Kontrolli i deformomit të trikotazheve.
- Përcaktimi i vetive qepëse.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e duhura të punës(lloje të ndryshme të trikotazheve);
- të identifikojë fijen(llojet e fibrave me anë të procesit të djegjes ose me mikroskop);
- të përcaktojë llojin e thurjes duke parë renditjen e sythave dhe shtyllave;
- të përcaktojë drejtimin të elasticitetit me anë të tërheqjes (në drejtimin gjatësor, gjerësor dhe diagonal);

- të përcaktojë koeficientin e zgjatjes dhe rikthimit të trikotazheve;
- të masë elasticitetin me metoda të ndryshme si (palosje diagonal, fikësim me gjilpëra me kokë);
- të kontrolloj defektet e shturjes me anë tërheqjes së trikotazheve;
- të vendos në tavolinë një copë trikotazhi në gjendje të lirë dhe të shoh efektin e përdredhjes;
- të përcaktojë trashësinë e trikotazheve (me anë të matjes së largësisë së dy sipërfaqeve të marra si të sheshta);
- të kontrollojë deformimin me anë të tërheqjes (në distancën midis dy spirave);
- të përcaktojë vetitë qepëse të trikotazheve;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në reparte të rrobaqepsisë
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të matjeve në mënyrë organoshqisore.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e analizave të ndryshme .
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e analizave të ndryshme të fijeve dhe pëlhurave të ndryshme të përzgjedhura nga instruktori i praktikës .
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e veprimeve mbi identifikimin e vetivetë ndryshme.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për kontrollin e saktësisë së llogaritjeve të ndryshme .
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e veprimeve mbi procedurat e punës.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për kryerjen e provave të fijeve dhe pëlhurave të ndryshme.



**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- repart pune;
 - pajisjet dhe mjetet e punës për analizat e ndryshme;
 - lëndë të para dhe ndihmëse si penj që kanë funksione të ndryshme
 - pëlhura të tezgjahuara dhe trikotazhe.
 - materiale të shkruara në mbështetje të modulit.
-

2. Moduli “Zbërthim modelesh fundi”



Drejtimi: Tekstil-Konfeksione

Profili: Modelim

Niveli: II

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	ZBËRTHIM MODELESH FUNDI	M-10-1243-16
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer veprimtari përgatitore për realizimin e vizatimit, skicimit, zbërthimit dhe realizimit të kampionëve të modeleve të ndryshme të fundeve për femra.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Tekstil – Konfeksion.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përgatit dhe pret modele të fundeve medy, tre ose më shumë pala. Përmbajtja <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.- Përzgjedhja e materialeve të punës.- Vendosja e raporteve (ose përpjestimet e veshjes) sipas përmasave trupore.- Përputhja e modelit me individin.- Vendosja e raporteve harmonike të ngjyrave.- Vizatimi i skemës gjeometrike të modelit të shoqëruar me prerje të fundeve me dy, tre ose më shumë pala.- Zbërthimi i pjesëve përbërëse (detaleve) për modelet e fundeve me dy, tre ose më shumë pala.- Ndërtimi i skicave teknike (kartëmodeli) të fundeve të modeluar me dy, tre ose më shumë pala.- Rregullimi i defekte trupore në kallëpin e prerjes- Përshtatja e materialit të pëlhurës me modelin dhe funksionin e veshjes.- Kombinimi i materjaleve të ndryshme (lisho, me dizenjo, me kuadrate etj.).- Vendosja në mënyrën e duhur të kallëpeve në tekstil.- Realizimi i prerjeve të elementëve përkatëse dhe detaleve.- Vendosja e cikatjeve dhe shenjave.- Pastrimi i vendit të punës.- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.	

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e nevojshme që nevojiten për ndërtimin e modelit;
- të vendosë saktë raportet trupore në vizatim;
- të realizojë përputhjen e modelit me individin;
- të vendosë saktë raportet e ngjyrave në model;
- të realizojëskemën gjeometrike (të shoqëruar me prerje) të modeleve të ndryshme të fundeve (dy,tre ose më shumë pala);
- të zbërthejë pjesët përbërëse të detaleve dhe elementëve të tjerë për modelet e fundeve me dy,tre ose më shumë pala;
- të ndërtojë skicat teknike të prerjes së pjesëve të ndryshme të fundeve me pala, sipas përmasave reale;
- të bëjë kontrollin e saktësisë së skicave;
- të përshtasë materialin e pëlhurës (trashësia dhe struktura e thurjes) me modelin dhe funksionin e veshjes;
- të kombinojë materiale të ndryshme në varësi të modelit;
- të vendosë në mënyrën e duhur kallëpet në tekstil;
- të presë elementët përkatës dhe detalet e fundeve me pala (dy,tre ose më shumë pala);
- të vendosë cikatjet dhe shenjatat e referimit në vendet e duhura;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 2 Nxënësi përgatit dhe pret modele të fundeve me rrotullim.

Përmbajtja

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e materialeve të punës.
- Vizatimi skematik i modeleve të ndryshme të fundeve me rrotullim(veref i plotë,1/2 ose 1/4 e rrotullimit në varësi të modelit).
- Zbërthimi i pjesëve përbërëse për modelet e fundeve me rrotullim(veref i plotë,1/2 ose 1/4 e rrotullimit në varësi të modelit).
- Ndërtimi i skicave teknike të fundeve të modeluar merrotullim(veref i plotë,1/2 ose 1/4 e rrotullimit në varësi të modelit).
- Kontrolli i saktësisë së skicave të prerjes.
- Vendosja në mënyrën e duhur të kallëpeve në tekstil.

- Realizimi i prerjeve të elementëve përkatës dhe detaleve.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e nevojshme (trashësia dhe struktura e thurjes) për realizimin e modeleve;
- të vizatojë modele të ndryshme të fundeve me rrotullim(veref i plotë,1/2 ose 1/4 e rrotullimit në varësi të modelit);
- të zbërthejë pjesët përbërëse për modelet e fundeve me rrotullim(veref i plotë,1/2 ose 1/4 e rrotullimit në varësi të modelit);
- të ndërtojë skicat teknike të fundeve të modeluar merrotullim(veref i plotë,1/2 ose 1/4 e rrotullimit në varësi të modelit);
- të kontrollojë saktësisë e skicave të prerjes;
- të vendosë në mënyrën e duhur kallëpet në tekstil;
- të realizojë prerjet e elementëve përkatës dhe detaleve;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 3 Nxënësi përgatit dhe pret modele fundesh me prerje (supanjë) dhe pala/rrudha në pjesën e poshtme.

Permbajtja

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e materialeve të punës.
- Përshtatja e materialit të pëlhurës me modelin dhe funksionin e veshjes.
- Vizatimi skematik i modeleve të ndryshme të fundeve me prerje(supanjë) dhe pala ose rrudha në pjesën e poshtme.
- Zbërthimi i pjesëve përbërëse për modelet e fundeve me prerje(supanjë) dhe pala ose rrudha në pjesën e poshtme.
- Ndërtimi i skicave teknike të fundeve të modeluar me prerje(supanjë) dhe pala ose rrudha në pjesën e poshtme.
- Kontrolli i saktësisë së skicave të prerjes.
- Ndërtimi i kallëpëve të modeluar të supanjave përkatëse si dhe pjesëve të poshtme të fundit.
- Vendosja në mënyrën e duhur të kallëpeve në tekstil.

- Realizimi i prerjeve të modeleve të ndryshme të fundeve.
- Krijimi i rrudhave ose palave në pjesë e poshtme.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e duhura të punës;
- të përshtasë materjalit e pëlhurës me modelin dhe funksionin e veshjes;
- të vizatojë modele të ndryshme të fundeve me prerje(supanjë) dhe pala ose rrudha;
- të zbërthejë pjesët përbërëse për modelet e fundeve me prerje(supanjë) dhe pala ose rrudha në pjesën e poshtme;
- të ndërtojë skicat teknike të fundeve të modeluar me prerje(supanjë) dhe pala ose rrudha në pjesën e poshtme;
- të kontrollojë saktësisë së skicave të prerjes;
- të ndërtojë kallëpët e modeluara të supanjave përkatëse si dhe pjesëve të poshtme të fundit;
- të vendosë në mënyrën e duhur të kallëpeve në tekstil;
- të realizojë prerjet e modeleve të ndryshme të fundeve;
- të krijojë rrudha ose pala në pjesë e poshtme;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 4 Nxënësi përgatit fundet e modeluara për provë.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse.
- Ildisja pjesëve përbërëse dhe detaleve të modeleve të fundeve.
- Kryerja e provës së modeleve të ndryshme të fundeve.
- Kostatimi i defekteve të ndryshme pas provës.
- Korrigjimi i defekteve të ndryshme pas provës.
- Prerja e astarit.
- Prerja e qemerit.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:



- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për provën e fundeve të modeluar;
- të përzgjedhë materialet e duhura të punës;
- të ildisë pjesët përbërëse dhe detalete modeleve të fundeve;
- të kryejë provën e qëndrimit në trup të fundeve të modeluara;
- të kostatojë defektet e ndryshme pas provës;
- të korrigjojë defektet e ndryshme pas provës;
- të presë me saktësi astarin;
- të presë me saktësi qemerin;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 5 Nxënësi kryen proceset përfundimtare të qepjes së fundeve të modeluara.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e materialeve të punës.
- Përzgjedhja e makinave qepëse për realizimin e kampionit të modelit.
- Fiksimi i materialit ngjitës me pëlhurën.
- Vendosja e tegelave zbukurues dhe aksesorëve të kampionit të modelit.
- Qepja e astarit sipas modelit.
- Qepja e pëlhurës sipas modelit.
- Qepja e patentin sipas modelit.
- Përdorimi i hekurosjeve në varësi të modeleve dhe materialit të përdorur.
- Llogaritja e kostos së modelit kampion.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për kryerjen e proceseve përfundimtare të qepjes së modeleve të fundeve;
- të përzgjedhë materialet e duhura të punës;

- të përzgjedhë makinat qepëse për realizimin e kampionit të modelit;
- të fiksojë materialit ngjitës me pëlhurën;
- të realizojë tegela të ndryshëm zbukurues në modelet e ndryshme të fundeve;
- të qepë astarin sipas modelit;
- të qepë pëlhurën sipas modelit;
- të qepë patentin sipas modelit;
- të realizojë tegela të ndryshëm zbukurues në modelet e ndryshme të fundeve;
- të hekurosë në varësi të modelit dhe materialit;
- të llogarisë koston e modelit kampion;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e rrobaqepësisë si dhe te organizohen vizita njohëse në ndërmarrje të konfeksionit.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë që është e mundur demonstrimet konkrete për modelimin, prerjen dhe qepjen e fundeve të modeluar për femra.
- Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për modelimin, prerjen dhe qepjen e fundeve të modeluar për femra.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të zbatohet vlerësimi mbi bazën e demonstrimit praktik të aftësive dhe njohurive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Kompleti i veglave dhe materialeve për modelimin, prerjen, qepjen e fundeve të modeluar.
 - Udhëzues, rregullore për kushtet teknike për modelimin, prerjen, qepjen e fundeve të modeluar.
-

3.Moduli “Zbërthim modelesh bluze”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione



Profili: Modelim

Niveli: II

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	ZBËRTHIM MODELESH BLUZE	M-10-1244-16
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer veprimtari përgatitore për të zbërthyer modele të ndryshme të bluzave për femra dhe meshkuj si dhe realizimin e kampionëve.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Tekstil – Konfeksion.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përgatit dhe pret modele të bluzave per femra me supanjë dhe jakë bebe.</p> <p><i>Përmbajtja</i></p> <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.- Përzgjedhja e materialeve të punës.- Vendosja e raporteve (ose përpjestimet e veshjes) sipas përmasave trupore- Përputhja e modelit me individin.- Vendosja e raporteve harmonike të ngjyrave- Vizatimi i skemës gjeometrike të modelit të shoqëruar me prerje (bluzave per femra me supanjë dhe jakë bebe).- Vizatimi i modeleve të ndryshme të supanjave.- Zbërthimi i pjesëve përbërëse për modelet e bluzave per femra me supanjë dhe jakë bebe.- Ndërtimi i skicave teknike të bluzave per femra me supanjë dhe jakë bebe.- Kontrolli i saktësisë së skicave të prerjes.- Përshtatja e materialit të pëlhurës (trashësia dhe struktura e thurjes) me modelin dhe funksionin e veshjes.- Vendosja në mënyrën e duhur të kallëpeve në tekstil.- Realizimi i prerjeve të elementëve përkatës dhe detaleve.- Pastrimi i vendit të punës.- Rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;	



-
- të përzgjedhë materialet e nevojshme që nevojiten për ndërtimin e modelit;
 - të vendosë saktë raportet trupore në vizatim;
 - të realizoj përputhjen e modelit me individin;
 - të realizoj harmonizimin e ngjyrave;
 - të realizoj skemën gjometrike (të shoqëruara me prerje) të modele të ndryshme të bluzave per femra me supanjë dhe jakë bebe;
 - të zbërthejë pjesët përbërëse të detaleve dhe elementëve të tjerë për modelet e bluzave per femra me supanjë dhe jakë bebe;
 - të realizoj vizatimin në manikinë të përpjestimeve dhe figurës gjometrike të bluzave per femra me supanjë dhe jakë bebe;
 - të vizatojë modele të ndryshme të bluzave me supanjë dhe jakë bebe;
 - të ndërtojë skicat e prerjes së pjesëve të ndryshme të modeleve të bluzave;
 - të përshtasë materjalin e pëlhurës(trashësia dhe struktura e thurjes) me modelin dhe funksionin e veshjes;
 - të vendosë në mënyrën e duhur kallëpet në teksil;
 - të presë kallëpet e modeleve të bluzave me supanjë dhe jakë bebe;
 - të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjiëno-sanitare;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mjedisit.

RM 2 Nxënësi përgatit dhe pret bluzat e modeluara me mëngë regland.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjetve të punës.
- Përzgjedhja e materialeve të punës.
- Vizatimi skematik i modeleve të bluzave per femra me mëngë.
- Zbërthimi i pjesëve përbërëse për modelet e bluzave per femra me mëngë regland(shpinë.përparëse,mëngë regland)
- Zbërthimi i pjesëve përbërëse të mëngës regland të zhvilluar.
- Ndërtimi i skicave teknike të bluzave per femra me mëngë regland.
- Vendosja e kallëpeve në tekstil.
- Realizimi i prerjeve të elementëve përkatës dhe detaleve.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e nevojshme;
- të vizatojë skemë gjeometrike të modelit të bluzë me mëngë regland të shoqëruar me prerje;
- të zbërthejë pjesët përbërëse të detaleve dhe elementëve për modelet e bluzave me mëngë regland;
- të ndërtojë skicat teknike të prerjes së pjesëve të bluzës me mëngë regland;
- të ndërtojë skicat teknike të prerjes së mëngës regland të zhvilluar;
- të vendosë në mënyrë duhur kallëpet mbi pëlhurë, duke ekonomizuar lëndën e parë;
- të presë elementët përkatës dhe detalet e bluzës me mëngë regland;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 3 Nxënësi përgatit dhe pret këmishën e modeluar për meshkuj.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e materialeve të punës.
- Vizatimi skematik i modeleve të këmishës së modeluar për meshkuj.
- Zbërthimi i pjesëve përbërëse të këmishës së modeluar për meshkuj (shpinë, përparëse, supanjë, mëngë, xhepa dhe jakës me kamë).
- Ndërtimi i skicave teknike të pjesëve përbërëse dhe detaleve të këmishës së modeluar për meshkuj.
- Vendosja në mënyrë duhur të kallëpeve në tekstil.
- Realizimi i prerjeve të elementëve përkatës dhe detaleve.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e nevojshme;
- të realizojë skemën gjeometrike të këmishës së modeluar për meshkuj;
- të zbërthejë pjesët përbërëse të këmishës së modeluar për

- meshkuj;
- të ndërtojë skicat e prerjes së pjesëve të këmishës së modeluar për meshkuj;
- të vendosë shenjat e referimit në skicë;
- të realizojë prerjen e elementëve përkatës dhe detaleve;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 4 Nxënësi përgatit për provë bluzat e modeluara për femra dhe meshkuj.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse.
- Kryerja e provës së modeleve të ndryshme të bluzave të modeluara.
- Kostatimi i defekteve të ndryshme pas provës.
- Korigjimi i defekteve të ndryshme pas provës.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e nevojshme;
- të kryejë provën e modeleve të ndryshme të bluzave të modeluara;
- të kostatojë defektet e ndryshme pas provës;
- të korigjojë defektet e ndryshme pas provës;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 5 Nxënësi kryen proceset përfundimtare të qepjes së bluzës së modeluar për femra dhe meshkuj.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e makinave qepëse për realizimin e kampionit të modelit.
- Qepja e patentin sipas modelit.
- Vendosja e zbukurimeve dhe aksesoreve të veshjes.
- Qepja e tegelave të sipërm dekorues tek mostrat.

- Përdorimi i hekurosjeve në varësi të modeleve dhe materjalit të përdorur.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për kryerjen e proceseve përfundimtare të qepjes së bluzës së modeluar për femra dhe meshkuj;
- të përzgjedhë makinat qepëse për realizimin e kampionit të modelit;
- të qepë kampionit e modelit;
- të vendosë aksesorë zbukurues;
- të qepë me tegel të sipërm dekorues mostrat;
- të hekurosë në varësi të modelit dhe materjalit;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e rrobaqepësisë si dhe të organizohen vizita njohëse në ndërmarrje të konfeksionit.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë që është e mundur demonstrimet konkrete për modelimin, zbërthimin, prerjen dhe qepjen e bluzave të modeluar për femra dhe meshkuj.
- Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për modelimin, zbërthimin, prerjen dhe qepjen e bluzave të modeluar për femra dhe meshkuj.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të zbatohet vlerësimi mbi bazën e demonstrimit praktik të aftësive dhe njohurive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Komplet i veglave dhe materialeve për modelimin, zbërthimin, prerjen, qepjen e bluzave të modeluara.
 - Udhëzues, rregullore për kushtet teknike për modelimin, prerjen, qepjen e bluzave të modeluara .
-

4. Moduli “Zbërthim modelesh pantalloni”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione

Profili: Modelim
Niveli: II
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe Kodi	ZBËRTHIM MODELESH PANTALLONI	M-10-1245-16
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer veprimtari përgatitore në realizimin e vizatimit, skicimit, zbërthimit dhe realizimit të modeleve të pantallonave për femra dhe meshkuj.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Tekstil – Konfeksion.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përgatit pantallona me tegel ne vijën e hekurit në përparëse dhe shpinë (për femra). Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës. - Përzgjedhja e materialeve të punës. - Marrja e masave të duhurapër pantallonat me tegel ne vijën e hekurit në përparëse dhe shpinë (për femra). - Nxjerrja e masave të nevojshme nga tabela e përmasave. - Vizatimi i modelit duke vendosur përpjestimet e përmasave të pantallonit. - Vizatimi skematik (me konture të jashtme të dhëna qartë) i linjave të hekurit dhe të gjitha linjat e tjera për së gjeri. - Zbërthimi i pjesëve përbërëse (në gjerësi deri afër tegelit para dhe mbrapa). - Ndërtimi i skicave teknike të prerjeve në pjesë. - Kontrolli i saktësisë së skicave të prerjes. - Përshtatja e materialit të pëlhurës me modelin dhe funksionin e veshjes (stofra një ngjyrësh). - Rregullimi i defekteve trupore në kallëpin e prerjes. - Rindërtimi i kallëpëve të rinj. - Vendosja në mënyrën e duhur të kallëpeve në tekstil. - Realizimi i prerjeve të elementëve përkatës dhe detaleve. - Vendosja e cikatjeve dhe shenjave. - Pastrimi i vendit të punës. - Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgim me listë kontrolli. 	



Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e nevojshme që nevojiten për ndërtimin e kartë modelit;
- të kryejë marrjen e masave të duhura për pantallonat me tegel në vijën e hekurit në përparëse dhe shpinë(për femra)
- të nxjerrë masat e nevojshme nga tabelat e përmasave);
- të zbërthejë pjesët përbërëse(në gjerësi deri afër tegelit para dhe mbrapa);
- të ndërtojë skicat e prerjes së pjesëve përbërëse;
- të bëjë kontrollin e saktësisë së skicave;
- të përshtasë materialin e pëlhurës me modelin dhe funksionin e veshjes;
- të rregullojë defektet trupore në kallëpin e prerjes;
- të rindërtojë kallëpet pas prerjeve të pjeseve(në gjerësi);
- të vendosë në mënyrën e duhur kallëpet në teksil;
- të realizoj prerjen e elementëve dhe detaleve;
- të vendosë cikatjet dhe shenjat e referimit në vendet e duhura, që korespondojnë me pjesët e tjera në skicë;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjiëno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 2 Nxënësi përgatit modelin e pantallonave zhupon për femra.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e materialeve të punës.
- Vizatimi skematik i modeleve të pantallonave zhupon për femra.
- Zbërthimi i pjesëve përbërëse për modelet e pantallonave zhupon për femra.
- Ndërtimi i skicave teknike të pantallonave zhupon për femra.
- Kontrolli i saktësisë së skicave të prerjes.
- Rregullimi i defekteve trupore në kallëpin e prerjes.
- Vendosja në mënyrën e duhur të kallëpeve në tekstil.
- Realizimi i prerjeve të elementëve përkatës dhe detaleve.
- Vendosja e cikatjeve dhe shenjave të referimit në vendet e duhura që korespondojnë me pjesët e tjera.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e nevojshme;
- të vizatoj modele të ndryshme të pantallonave zhupon për femra;
- të zbërthejë pjesët përbërëse për modelet e pantallonave zhupon për femra;
- të ndërtojë skicat e prerjes së pjesëve të pantallonave zhupon për femra;
- të bëjë kontrollin e saktësisë së skicave;
- të presë kallëpet e pjesëve të pantallonave zhupon për femra;
- të vendosë kallëpet mbi pëlhurë duke ekonomizuar lëndën e parë;
- të presë në pëlhurë pjesët përbërëse të detaleve dhe elementëve të tjerë;
- të vendosë cikatjet dhe shënjat e referimit në vendet e duhura dhe që korespondojnë me pjesët e tjera;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 3 Nxënësi modelon pantallonat me (një ose dy) pala dhe mashetë për meshkuj.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e materialeve të punës.
- Vizatimi i modelit duke vendosur përpjestimet e përmasave trupore.
- Vizatimi skematik i plotë i modelit të pantallonave me (një ose dy) pala dhe mashetë për meshkuj.
- Zbërthimi i pjesëve përbërëse të modelit të pantallonave me (një ose dy) pala dhe mashetë për meshkuj.
- Vizatimi i veçantë i pjesëve përbërëse të elementëve dhe detaleve (xhepa, pala) për të pasur të qartë prerjet e tyre.
- Ndërtimi i skicave teknike të modelit të pantallonave me (një ose dy) pala dhe mashetë për meshkuj.
- Kontrolli i saktësisë së skicave të prerjes.
- Rregullimi i defekteve trupore në kallëpin e prerjes.
- Vendosja në mënyrën e duhur të kallëpeve në teksil.
- Realizimi i prerjeve të elementëve përkatës dhe detaleve.
- Vendosja e cikatjeve dhe shënjave të referimit.
- Pastrimi i vendit të punës.

- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e nevojshme që nevojiten për ndërtimin e kartë modelit;
- të vizatojë modelit duke vendosur përpjestimet e përmasave trupore (në manikinë);
- të realizojë skemën gjeometrike të modelit të pantllonave me (një ose dy) pala dhe mashetë për meshkuj (me dy pamje para dhe mbrapa);
- të realizojë zbrëthimin e skicës teknike të pjesëve përbërëse dhe detaleve;
- të ndërtojë skicat e prerjes së pjesëve të modelit të pantllonave me (një ose dy) pala dhe mashetë për meshkuj;
- të bëjë kontrollin e saktësisë së skicave;
- të eliminoj defektet trupore në kallëpin e prerjes;
- të vendosë kallëpet mbi pëlhurë në drejtimin gjatësor të pëlhurës;
- të presë në pëlhurë pjesët përbërëse të detaleve dhe elementëve të tjerë;
- të vendosë cikatjet dhe shenjat në vendet e duhura dhe që korespondojnë me pjesët e tjera;
- të presë në pëlhurë pjesët e pantllonave;
- të presë astaret për xhepat anësore dhe qemerin;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 4 Nxënësi përgatit për provë pantallonat e modeluara për femra dhe meshkuj.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Frazelinimi i qemerit.
- Ildisja e pantllonave.
- të kryej provën e modeleve të ndryshme të pantllonave e të modeluara për femra dhe meshkuj.
- të kostatojë defektet e ndryshme pas provës.
- të korigjojë defektet e ndryshme pas provës.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.



Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për provën e pantallonave;
- të frazelinojë me kujdes qemerin;
- të ildisë pjesët endryshme të pantallonave;
- të ildisë palat e pantallonave;
- të kryejë provën e parë të qëndrimit në trup të pantallonave;
- të kryejë rregullimin e pantallonave pas kryerjes së provës;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 5 Nxënësi kryen proceset përfundimtare të qepjes së pantallonave të modeluara për femra dhe meshkuj.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e makinave qepëse për realizimin e kampionit të modelit.
- Qepja e kampionit.
- Vendosija e zburimeve dhe aksesorëve të veshjes.
- Qepja e tegelave të sipërm dekorues.
- Përdorimi i hekurosjeve në varësi të modeleve dhe materialit të përdorur.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për kryerjen e proceseve përfundimtare të qepjes së pantallonave të modeluara për femra dhe meshkuj;
- të përzgjedhë makinat qepëse për realizimin e kampionit të modelit;
- të qepë kampionit e modelit;
- të vendosë aksesorë zburues;
- të qepë me tegel të sipërm dekorues;
- të hekurosë në varësi të modelit dhe materialit;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat

- higjiëno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e rrobaqepësisë si dhe të organizohen vizita njohëse në ndërmarrje të konfeksionit.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë që është e mundur demonstrimet konkrete për modelimin, prerjen dhe qepjen e pantallonave të modeluar për femra dhe meshkuj.
- Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për modelimin, zberthimin, prerjen dhe qepjen e pantallonave të modeluar për femra dhe meshkuj.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të zbatohet vlerësimi mbi bazën e demonstrimit praktik të aftësive dhe njohurive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Kompleti i veglave dhe materialeve për modelimin, zberthimin, prerjen, qepjen e pantallonave të modeluara për femra dhe meshkuj.
 - Udhëzues, rregullorë për kushtet teknike për modelimin, zberthimin, prerjen, qepjen e pantallonave të modeluara .
-

5. Moduli “Zberthim modelesh xhakete”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione



Profili: Modelim
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	ZBËRTHIM MODELESH XHAKETE	M-10-1246-16
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer veprimtari përgatitore në realizimin e vizatimit, skicimit, zbërthimit dhe realizimit të modeleve të xhaketave për femra dhe meshkuj	
Kohëzgjatja e modulit	85 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Tekstil – Konfeksion.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përgatit dhe pret modele të ndryshme të xhaketave për femra. Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës. - Përzgjedhja e materialeve të punës. - Marrja e masave të duhurapër modele të ndryshme të xhaketave për femra. - Nxjerrja e masave të nevojshme nga tabela e përmasave. - Vizatimi i modeleve duke vendosur përpjestimet e përmasave të xhaketës. - Vizatimi skematik(me konture të jashtme të dhëna qartë) të modeleve të xhaketave për femra. - Zbërthimi i pjesëve përbërëse të modeleve të ndryshme të xhaketave për femra. - Ndërtimi i skicave teknike të prerjeve në pjesë të xhaketës monopet dhe dopiopet. - Ndërtimi i skicave teknike të prerjeve në pjesë të xhaketës me pjesë anësore(fjanket). - Ndërtimi i skicave teknike të prerjeve në pjesë të xhaketës Princeshë. - Ndërtimi i skicave teknike të prerjeve në pjesë të xhaketës Sahariane. - Ndërtimi i skicave teknike të prerjeve në pjesë të xhaketës me modele të ndryshme të jakave. - Ndërtimi i skicave teknike të prerjeve në pjesë të xhaketës me modele të ndryshme të mëngëve. - Ndërtimi i skicave teknike të prerjeve në pjesë të 	



Bolerove të modeluara.

- Kontrolli i saktësisë së skicave të prerjes.
- Përshtatja e materialit të pëlhurës me modelin dhe funksionin e veshjes.
- Rregullimi i defekteve trupore në kallëpin e prerjes.
- Vendosja në mënyrën e duhur të kallëpeve në tekstil.
- Realizimi i prerjeve të elementëve përkatës dhe detaleve.
- Vendosja e cikatjeve dhe shenjave të referimit në vendet e duhura.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e nevojshme që nevojiten për ndërtimin e modeleve të ndryshme;
- të kryejë marrjen e masave të duhura për modele të ndryshme të xhaketave për për femra;
- të nxjerrë masat e nevojshme nga tabelat e përmasave
- të realizoj vizatimin në manikinë të përpjestimeve dhe figurës gjeometrike tëmodeleve tëxhaketave për femra;
- të zbërthejë pjesët përbërëse të modeleve të ndryshme të xhaketave për femra;
- të ndërtojë skicat e prerjes së pjesëve të ndryshme të modeleve të ndryshme të xhaketave për femra;
- të bëjë kontrollin e saktësisë së skicave;
- të përshtasë materjalin e pëlhurës me llojin e modelin dhe funksionin e veshjes;
- të rregullojë defektet trupore në kallëpin e prerjes;
- të vendosë në mënyrën e duhur kallëpet në tekstil;
- të realizojë prerjen e elementëve dhe detaleve të modeleve të ndryshme të modeleve të ndryshme të xhaketave për femra;
- të vendosë cikatjet dhe shenjat e referimit në vendet e duhura që korespondojnë me pjesët e tjera;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 2 Nxënësi përgatit dhe pret modele të ndryshme të xhaketave për meshkuj.

Përmbajtja:



- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e materialeve të punës.
- Marrja e masave të duhura për modele të ndryshme të xhaketave për meshkuj.
- Nxjerrja e masave të nevojshme nga tabela e përmasave.
- Vizatimi i modeleve duke vendosur përpjestimet e përmasave të xhaketave të modeluarapër meshkuj.
- Vizatimi skematik(me konture të jashtme të dhëna qartë) të modeleve të xhaketave për meshkuj.
- Zbërthimi i pjesëve përbërëse të modeleve të ndryshme të xhaketave për meshkuj.
- Ndërtimi i skicave teknike të prerjes së jakës sport dhe shall të xhaketës monopet dhe dopiopet për meshkuj.
- Ndërtimi i skicave teknike të prerjeve në pjesë të xhaketës Frak.
- Ndërtimi i skicave teknike të prerjeve në pjesë të xhaketës Tight.
- Ndërtimi i skicave teknike të prerjeve në pjesë të xhaketës Spencer.
- Kontrolli i saktësisë së skicave të prerjes.
- Rregullimi i defekteve trupore në kallëpin e prerjes.
- Vendosja në mënyrën e duhur të kallëpeve në tekstil.
- Realizimi i prerjeve të elementëve përkatës dhe detaleve.
- Vendosja e cikatjeve dhe shënjave të referimit.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e nevojshme, që nevojiten për ndërtimin e kartë modelit;
- të kryejë marrjen e masave të duhura për modele të ndryshme të xhaketave për meshkuj;
- të nxjerrë masat e nevojshme nga tabelat e përmasave;
- të realizojë vizatimin në manikinë të përpjestimeve dhe figurës gjeometrike të xhaketave për meshkuj;
- të zbërthejë pjesët përbërëse të modeleve të ndryshme të xhaketave për meshkuj;
- të ndërtojë skicat e prerjes së pjesëve të ndryshme të modeleve të xhaketave për meshkuj;
- të bëjë kontrollin e saktësisë së skicave;
- të përshtasë materialin e pëlhurës me modelin dhe funksionin e veshjes;

- të rregullojë defektet trupore në kallëpin e prerjes;
- të vendosë në mënyrën e duhur kallëpet në tekstil;
- të realizoj prerjen e elementëve dhe detaleve të modeleve të ndryshme të xhaketave për meshkuj;
- të presë në pëlhurë pjesët përbërëse të detaleve dhe elementëve të tjerë;
- të vendosë cikatjet dhe shënjat në vendet e duhura dhe që korespondojnë me pjesët e tjera;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 3 Nxënësi përgatit për provën e parë xhaketat e modeluara për femra dhe meshkuj.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse.
- Kryerja e proceseve të punës për përgatitjen për provën e parë të xhaketave të modeluara për femra dhe meshkuj.
- Kopjimi i shënimeve nga pjesa e lartme në atë të poshtme.
- Qepja e xhepave (sipas llojit të xhepit).
- Ildisja e pjesëve të shpinës.
- Bashkimi i shpinës me përparësen e xhaketave të modeluara (femra dhe meshkuj).
- Kryerja e provës së parë të xhaketave të modeluara për femra dhe meshkuj.
- Kostatimi i defekteve të ndryshme pas provës së parë.
- Korigjimi i defekteve të ndryshme pas provës së parë.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e nevojshme për realizimin e provave;
- të përgatisë xhaketat për kryerjen e provave përkatëse;
- të kryej provën e parë të xhaketave të modeluara për femra dhe meshkuj;
- të kopjojë me penjë-kopjues shënimet nga pjesët e lartme në ato të poshtme të shpinës dhe përparëses;
- të qepë xhepat (sipas llojit të modelit);
- të bashkojë me ildi shpinën me përparësen e xhaketës;

- të kryejë provën e parë të qëndrimit në trup të xhakëtës;
- të identifikojë modifikimet të cilat janë të nevojshme në gavaturë dhe në linjën e xhakëtës;
- të modifikojë xhakëtën pas kryerjes së provës së parë, duke hapur supet;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 4 Nxënësi përgatit për provën e dytë xhaketat e modeluara për femra dhe meshkuj.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për provën e dytë.
- Vendosja e përforcuesit.
- Frazelinimi i bashkimit të petës me kanavacën.
- Qepja e mostrave.
- Kthimi i mostrave.
- Qepja e trupit të xhakëtës(sipas modelit).
- Frazelinimi i pjesës së poshtme të xhakëtës(sipas modelit).
- Bashkimi i shpinës me përparëset e xhakëtës (sipas modelit)
- Hekurosja e rafive të qepjes (sipas modelit).
- Përgatitja e astarit të xhakëtës (sipas modelit).
- Qepja e astarit me përparëset .
- Hekurosja e qepjeve.
- Fiksimi i astarit me përparëset.
- Kthimi i palës së xhakëtës.
- Përgatitja e jakës së poshtme.
- Montimi i kanavacës në jakë.
- Ildisja e jakës së poshtme.
- Përgatitja e mëngës.
- Qepja e hapjes së mëngës.
- Bashkimi i mëngës.
- Hekurosja e rafive të mëngës.
- Qepja e astarëve të mëngëve.
- Hekurosja e rafive.
- Ildisja e astarëve në mëngë.
- Qepja e gavaturave të xhakëtës.
- Ildisja e mëngës në gavaturë.
- Kryerja e provës së dytë.
- Kostatimi i defekteve të ndryshme pas provës së dytë.
- Korigjimi i defekteve të ndryshme pas provës së dytë.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së



mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për provën e dytë të xhaketës;
- të vendosë përforcuesin përgjatë gjatësisë së petës si dhe tek thyerja e saj;
- të qepë trupin e xhaketës;
- të qepë mostrat në përparëset, duke i dhënë mulesat e duhura mostrave nga peta e lart dhe xhaketës nga peta e poshtë;
- të kthejë mostrat nëpërmjet ildive, duke bërë të mbivendoset peta nga thyerja e saj e lart dhe të mbivendoset xhaketa (sipas modelit) nga kopsa e poshtë;
- të qepë trupin e xhaketës (sipas modelit);
- të frazelinojë pjesën e poshtme të xhaketës (sipas modelit)dhe mëngët;
- të bashkojë shpinën me përparëset e xhaketës (sipas modelit);
- të pëgatisë astarin me xhaketën (sipas modelit);
- të qepë trupin e astarit me përparëset;
- të kthejë palën e xhaketës nëpërmjet ildisë;
- të bashkojë pjesët e jakës (sipas modelit) së poshtme;
- të japë formën e duhur jakës së poshtme;
- të qepë kanavacën duke i dhënë formën e duhur kamës së jakës dhe jakës nëpërmjet kllapave;
- të ildisë jakën e poshtme në xhaketë;
- të përgatisë mëngën për qepje (sipas modelit);
- të qepë hapjet e mëngëve;
- të kryejë bashkimin e mëngës (sipas modelit);
- të hekurosë rafitë e mëngës;
- të qepë astarët e mëngëve;
- të qepë gavaturat e xhaketës, për ruajtjen e formës nëpërmjet ildive përforcuese;
- të ildisë mëngët në xhaketë, duke i dhënë mulesat e duhura;
- të kryejë provën e dytë të qëndrimit në trup, duke parë qëndrimin e saj, mulesat në kokën e mëngës, shtrimin e jakës;
- të rregullojë xhaketën pas provës së dytë;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjiëno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së

mjedisit.

RM 5 Nxënësi kryen proceset përfundimtare të qepjes së modeleve të ndryshme të xhaketave për femra dhe meshkuj.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e makinave qepëse për realizimin e kampionit të modelit.
- Qepja e kampionit sipas modelit.
- Vendosja e zburimeve dhe aksesorëve të veshjes.
- Qepja e tegelave të sipërm dekorues.
- Përdorimi i hekurosjeve në varësi të modeleve dhe materjalit të përdorur.
- Pastrimi i xhaketës nga penjtë.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për kryerjen e proceseve përfundimtare të qepjes së xhaketave të modeluara për femra dhe meshkuj;
- të përzgjedhë makinat qepëse për realizimin e kampionit të modelit;
- të qepë kampionin e modelit;
- të vendosë aksesorë zburues;
- të qepë me tegel të sipërm dekorues;
- të hekurosë kampionin duke përdorur pëlhurë;
- të pastrojë xhaketën nga penjtë;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 6 Nxënësi llogarit çmimin për secilin model xhakete.

Përmbajtja:

- Përgatitja e preventivit të kampionit.
- Përllogaritja e kostos së kampionit.
- Përllogaritja e çmimit për lloje të ndryshme modelesh të xhaketave.
- Plotësimi i faturës për klientin.
- Komunikimi me etikë me klientin.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë preventivin e kampionit;
- të përlllogarisë koston e kampionit;
- të përlllogarisë çmimin për lloje të ndryshme modelesh të xhaketave;
- të plotësojë faturën për klientin gjatë shitjes së modelit të qepur;
- të komunikojë me etikë me klientin.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në reparte të rrobaqepsisë
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të proceseve për modelimin ,zbërthimin e modeleve, prerjen dhe qepjen e xhaketave të modeluara për femra e meshkuj.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për modelimin ,zbërthimin e modeleve, prerjen dhe qepjen e xhaketave të modeluara për femra e meshkuj.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e veprimeve mbi modelimin ,mënyrat e zbërthimit të pjesëve përbërëse të xhaketës, astareve në pëlhurë dhe fortesë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e veprimeve mbi konfeksionimin e xhaketave të modeluara për femra e meshkuj.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- repart rrobaqepsie;
 - pajisjet dhe mjetet e punës së rrobaqepësit;
 - lëndë të para dhe ndihmëse për modelimin ,zbërthimin e modeleve, prerjen dhe qepjen e xhaketave të modeluara për femra e meshkuj.
 - pankarta, makete, udhëzues, katalogë modeli etj.
-

6. Moduli “Zbërthim modelesh pallto”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione
Profili: Modelim
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	ZBËRTHIM MODELESH PALLTO	M-10-1247-16
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të modeluar, zbërthyer, ndërtuar kallëpe dhe për të qepur pallto të modeleve të ndryshme për femra dhe meshkuj.	
Kohëzgjatja e modulit	68 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Tekstil-Konfeksione.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi ndërton kallëpe për modele të ndryshme të palltove për femra. Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës. - Përzgjedhja e materialeve ndihmëse. - Marrja e masave të duhura për modele të ndryshme të pallto për femra. - Përcaktimi i lirshmërisë së palltos. - Përshtatja e materialit të pëlhurës me modelin dhe funksionin e veshjes. - Vizatimi i modelit duke vendosur përpjestimet e përmasave për modele të ndryshme të pallto për femra. - Vizatimi skematik të modeleve të ndryshme të pallto për femra. - Zbërthimi i pjesëve përbërëse të modeleve të ndryshme të palltos për femra. - Ndërtimi i skicave teknike të prerjeve në pjesë të modelit të palltos monopet dhe dopiopet. - Ndërtimi i skicave teknike të prerjeve në pjesë të palltos së lirshme për femra. - Ndërtimi i skicave teknike të prerjeve në pjesë të palltos “Loden”. - Ndërtimi i skicave teknike të prerjeve në pjesë të palltos “Rendigotë”. - Ndërtimi i skicave teknike të prerjeve në pjesë të palltos “Montgomeri”. - Ndërtimi i skicave teknike të prerjeve në pjesë të palltos 	


